



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER STELA R. DEMNERI
ADRESA NR.5, GJIK KUQALI,
PALL "FERAR", NR.1, NR.13
TEL: 692437001



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1915

Nr. koleksioni: 712

Tirane më 05/07/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021051380079886356

REPubLIKA E SHQIPERISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

Nr. 1915 Rep.

Nr. 712 Kol.



A2021051380079886356

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË “ARENA MK” SH.P.K)

Sot, më datë 05 / 07 / 2021, para meje Notere Stela R. Demneri, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Nr.5, Rr. “Gjik Kuqali”, Pall “Ferar”, Nr.1, Nr.13, u paraqitën personalisht:

PALA SHITËSE:

Z. Endrit Myrtaj, atësia Kujtim, amësia Natasha, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë rruga “Ibrahim Dervishi”; Nd. 3; H. 25; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 20/02/1992, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034872978 dhe nr. personal **J20220057B**, në cilësinë e ortakut të shoqërisë “ARENA MK” sh.p.k, NUIS **L67619801Q**, me adresë Fier Qender – mallakastër Dukas, Rruga nacionale Ballsh – Fier.

PALA BLERËSE:

Znj. Natasha Myrtaj, atësia Hasan, amësia Refije, shtetase Shqiptare, lindur në Donofrosë, Berat dhe banuese në Tiranë, me adresë rruga “Irfan Tomini”; Nd. 1844; H. 3; Ap. 053; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 05/02/1967, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033885565 dhe nr. personal **G75205109R**.

Baza ligjore: Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë ; Ligji nr. 110 / 2018 ‘Për Noterinë’; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 ‘Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare’, i ndryshuar.

KUSHTE PARAPRAKE:

1. Kapitali i shoqërisë “ARENA MK” sh.p.k, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NUIS **L67619801Q**, është në total **ALL 10.000,00** (dhjetë mijë Lekë) dhe numër të përgjithshëm kuotash 100,00. Pala shitëse **Z. Endrit Myrtaj**, është ortak me 24% (njëzet e katër përqind) të kuotës së shoqërisë me vlerë kapitali prej 2.400,00 Lekë (dymijë e katër qind).
2. Znj.Natasha Myrtaj zotëron 52% (pesëdhjetë e dy përqind) të kuotës me vlerë kapitali të barazvlefshme me 5.200,00 Lekë(pesë mijë e dyqind).
3. Ortaku **Z. Endrit Myrtaj**, bazuar në të drejtën që i njeh ligji dhe statuti (bazuar kjo në ligjin nr. 9901/2008 ‘Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare’, i ndryshuar, si dhe në Statutin e shoqërisë), ka vendosur transferimin e plotë të kuotës së tij nëpërmjet shitjes, në favor të blerësit **Znj.Natasha Myrtaj**.



Pra ortakı i kalon kuotën e tij të plotë prej 24 % (njëzetë e katër përqind) të kapitalit total , me vlerë ALL 2.400,00 lekë Znj. Natasha Myrtaj.

Neni 1

Objekti i kontratës

Pala shitëse dhe njëkohësisht ortakı i shoqërisë “ARENA MK” sh.p.k, i transferon Znj. **Natasha Myrtaj**, nëpërmjet shitjes, me anë të kësaj kontrate, me vullnet të lirë e të plotë, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe statutin e shoqërisë, 100 % të kuotës që ai zotëron në këtë shoqëri, konkretisht 24% (njëzetë e katër përqind) të totalit të kuotës së shoqërisë “ARENA MK” sh.p.k. Kjo përqindje kuote përkon në para në vlerën nominale sipas ekstraktit bashkëlidhur.

Neni 2

Çmimi i shitjes dhe mënyra e likuidimit

Çmimi i shitjes së 24 % të kuotës që zotëron pala shitëse në shoqërinë “ARENA MK” sh.p.k dhe që transferohet nëpërmjet kësaj kontrate në favor të palës blerëse është në total **ALL 2.400,00 (dymije e katërqind mijë lekë)**.

Vlera monetare sipas së cilës do të kryhet kalimi i kuotave në emër të palës blerëse përkon me raportin që këto kuota zënë në totalin e kapitalit të shoqërisë, konkretisht në vlerën **ALL 2.400,00**.

Çmimi i shitjes në vlerën totale prej **ALL 2.400,00** është shlyer nga pala blerëse jashtë kësaj zyre noteriale dhe shitësit nuk kanë ndonjë pretendim lidhur me këtë.

Neni 3

Garancitë

Pala shitëse **Z. Endrit Myrtaj**, deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotës që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate dhe se kuota është e lirë nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Pala shitëse deklaron se ligji dhe statuti ja njohin të drejtën për të nënshkruar këtë kontratë kalimi kuote ortakut të shoqërisë.

Deri në momentin që kjo kontratë të regjistrohet pranë QKB dhe kuotat të kalojnë përfundimisht në emër të palës blerëse, përgjegjësitë në lidhje me problematika juridike, ekonomike apo financiare të kuotës janë përgjegjësi e palës shitëse.

Neni 4

Heqja dorë nga të drejtat

Pala shitëse, **Z. Endrit Myrtaj** deklaron nën përgjegjësinë personale se pas nënshkrimit të kësaj kontrate heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në cilësinë e ortakut të shoqërisë mbi 100 % të kuotës së tij (24 % e kuotës totale), e cila nëpërmjet kësaj kontrate i kalon palës blerëse dhe e bën **Zj. Natasha Myrtaj** ortakë të shoqërisë **me 76 % të kuotës së kapitalit total**.

Neni 5

Efekte ligjore

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në institucionet përkatëse (QKB, etj), ortakëria e shoqërisë “ARENA MK” sh.p.k do të rezultojë:



A2021051380079886356

- I. Znj. Natasha Myrtaj, NID G75205109R – ortakë me 76 % (shtatëdhjetë e gjashtë përqind) të kuotës me vlerë ALL 7.600,00 lekë (shtatë mijë e gjashtëqind Lekë).
- II. Z. Arben Myrtaj, NID J30304042Q – ortakë me 24 % (njëzet e katër përqind) të kuotës me vlerë ALL 2.400,00 lekë (dymijë e katërqind Lekë).

Neni 6

Regjistrimi i kontratës në institucionet përkatëse dhe ndryshimi i statutit

Pala shitëse deklaron se është dakort që pala blerëse të mund të kryej të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e kësaj kontrate në institucionet përkatëse (sikurse QKB) si dhe paraqitjen e saj në institucione ku është e nevojshme (banka, bashki, komunë, institucione private, etj.).

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo lloj mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata u hartua në gjuhën shqipe dhe u lexua qartë në prani të paleve. Pasi ata deklaruan se u njohën dhe i kuptuan efektet juridike të aktit, e nënshkruan atë rregullisht përpara meje noteres. Kjo kontratë, u hartua në 4 (katër) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të paleve.

Unë noterja, verifikova identitetin e tyre nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "II", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e deklaruesit. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj deklarate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALA SHITËSE

Z. Endrit Myrtaj

PALA BLERËSE

Znj. Natasha Myrtaj



NOTER

STELA R. DEMNERI

